



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 703/19 Prot.

Durrës, më 5.4.2024

VENDIM

Nr. 31, datë 5.4. 2024

PËR

**"SHPLLJEN E ZGJEDHJEVE TË REJA PËR SEKRETAR TË KOMISIONIT
INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE NË UNIVERSITETIN
"ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë", të vendimit të Senatit Akademik nr.29 datë 29.03.2024 për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", neni 6, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Shpalljen e zgjedhjeve të reja për sekretar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Kandidatët për sekretar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve janë anëtar pa të drejtë vote pranë këtij Komisioni.
3. Kandidatët për sekretar të KIZ-it janë staf akademik me karakter administrativ me kohë të plotë dhe vetëkandidohen.
4. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:
 - Kërkesën për kandidim (formulari bashkëlidhur);
 - Kopjen e dokumentit të identifikimit;
 - Vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore (formulari bashkëlidhur);
5. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar për kandidim, sekretaria e Senatit Akademik pasi konfirmon të dhënat për stafin akademik me karakter administrativ me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, përcjellë listën e kandidaturave të regjistruara për votim në Senatin Akademik.
6. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë Sekretarisë së Senatit Akademik është nga data 8.4.2024 deri me datë 12.04.2024 .

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Dekanët e Fakulteteve
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike
- Drejtoria e Administrimit dhe e Shërbimeve Akademike
- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë
- Drejtoria e Projekteve dhe e Marrëdhënieve me Jashtë
- Qendra për Kërkim dhe Ekselencë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksenela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
SENATI AKADEMIK

Durrës, më __ / __ /2024

FORMULAR APLIKIMI
PËR SEKRETAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur
më __/__/__, në _____, staf akademik me karakter administrativ, me kohë të
plotë, me detyrë _____, pranë _____ paraqes kërkesën
time për të qenë sekretar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve.

Emër, Mbiemër/ Nënshkrimi

FORMULAR VETEDEKLARIMI

Te dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri	
Atësia, Mëmësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (nje kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lire se jam :

i/e padënuar i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRESI I VETEDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë

Autorizim : Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta

dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale ne vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22. 07. 1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
Deklarimi I rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.